



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 159

Tiranë – E premte, 2 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13874, datë 25.11.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 18977
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 1.12.2022	Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2023..... 18977
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 1.12.2022	Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç..... 18978
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 1.12.2022	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2022..... 18978
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 1.12.2022	Për kompensimin e të ardhurave të personave që përfitojnë pension invaliditeti, për vitin 2022..... 18979
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 1.12.2022	Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2022..... 18980
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 1.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar..... 18980
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 11, datë 24.11.2022	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kontrollin e veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë..... 18981
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 547, datë 22.11.2022	Për disa ndryshime në urdhrin e ministrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”..... 18996
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 286, datë 10.11.2022	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”..... 19010

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 287, datë 10.11.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	19011
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 10.11.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Idro Energia Pulita” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19013
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 289, datë 10.11.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Energy Sotira” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19014
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 290, datë 10.11.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw.....	19015
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 291, datë 10.11.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi licencimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	19016
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 292, datë 10.11.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi licencimin e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.....	19017
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 293, datë 10.11.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	19019



DEKRET
Nr. 13874, datë 25.11.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, të nenit 20, dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, për:

Dua Dukagjin Lipa

Për kontributin e veçantë, si vlerë kombëtare në fushën e artit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 750, datë 1.12.2022

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR
VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2023, në shumën 381 500 000 (treqind e tetëdhjetë e një milionë e pesëqind mijë

lekë), sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE,
PËR VITIN 2023

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	159,000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	117,800
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	126,000	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15,600
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	6,550
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	19,400	Shpenzime për shërbime	163,406
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	9,500	Shpenzime për investime	78,144
Të ardhura nga pagesa për domain	6,900		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	200		
Të ardhura nga komisioni nga agjenti tatimor	24,500		
Total i të ardhurave	381,500	Totali shpenzimeve	381,500



VENDIM

Nr. 751, datë 1.12.2022

**PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË NGJA
SHTETI PËR GRATË E PAPUNA ME
TRE APO MË SHUMË FËMIJË TË
MOSHËS DERI NË 18 VJEÇ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 58, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrë lindjeje.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore për degën e sigurimit të pensioneve dhe degën e sigurimit të barrë lindjes paguhen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi.

3. Shërbimi Social Shtetëror përcakton listën e grave që përfitojnë mbrojtje të veçantë dhe çdo muaj llogarit dhe kryen pagesën e kontributeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2023.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 752, datë 1.12.2022

**PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE
PËR FESTAT E FUNDVITIT 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat, që përfitojnë pension, sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

c) Personat, që përfitojnë pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”, personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Personat, që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së



Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a dhe/ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ë) Personat, që nuk përfitojnë pension, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

f) Personat, që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

g) Personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi e kanë edhe ata persona që u lind e drejta për përfitimin e pensionit deri në datën 31.12.2022, përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë ta

marrin vetëm një herë këtë shpërblim, pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 3 503 309 000 (tre miliardë e pesëqind e tre milionë e treqind e nëntë mijë), e ndarë në 3 475 505 000 (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesë mijë) lekë për shpërblimin dhe 27 804 000 (njëzet e shtatë milionë e tetëqind e katër mijë) lekë komisione dhe shpenzime të tjera. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i miratuar për vitin 2022.

4. Shpërblimet do të kalojnë në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2022 dhe do të paguhën gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2022, ato do të paguhën gjatë vitit të ardhshëm. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen me kalimin e 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e miratimit të këtij vendimi.

5. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura që zbatohen për administrimin e fondit të Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve, sipas programeve në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 753, datë 1.12.2022

PËR KOMPENSIMIN E TË
ARDHURAVE TË PERSONAVE
QË PËRFITOJNË PENSION
INVALIDITETI, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në



Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë të personave, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për vitin 2022.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 642 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë) dhe përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi, të cilët autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 754, datë 1.12.2022

PËR SHPËRBLIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E FUNDVITIT 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar shpërblehen financiarisht, për vitin 2022, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familjet të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 399 000 000 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë) lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 755, datë 1.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHËRBIMIN SPITALOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 6, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Pika 8, e vendimit nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Çmimet e paketave të shërbimeve shëndetësore rishikohen periodikisht, sipas vlerësimit të faktorëve socialë, ekonomikë dhe shëndetësorë nga një komision i kostifikimit të paketave shëndetësore, i cili përcaktohet nga Këshilli Administrativ i Fondit, me pjesëmarrës nga shërbimet shëndetësore publike, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Fondit. Ndryshimi i çmimeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
BELINDA BALLUKU**

**UDHËZIM
Nr. 11, datë 24.11.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË HOLLËSISHME PËR KONTROLLIN
E VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 58, pika 6, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e rregullave të hollësishme për kontrollin e veprimtarisë së përmbartuesve gjyqësorë privatë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen struktura përgjegjëse për veprimtaritë e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Privat, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve

Gjyqësorë Privatë dhe përmbartuesit gjyqësorë privatë për ndjekjen dhe zbatimin këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja**

**RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR
KONTROLLIN E VEPRIMTARISË SË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

**TABELA E PËRMBAJTJES
HYRJE**

1.1 Qëllimi i kontrollit të veprimtarisë së përmbartuesve gjyqësorë privatë

1.2 Objektivat e kontrollit

1.3 Metodologjia e kontrollit

**2. KONTROLI I VEPRIMTARISË SË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

2.1 Të drejtat dhe detyrimet e përmbartuesve të kontrolluar

2.2 Përbërja dhe kompetencat e grupit të kontrollit

2.3 Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të kontrollit

3. KONTROLI

3.1 Kontrolli i përgjithshëm

3.2 Kontrolli i veçantë

3.3 Fazat e kontrollit

3.3.1 Kontrolli i mëparshëm në terren

3.3.2 Kontrolli aktual në terren

3.4 Vendndodhja – sipërfaqja

3.5 Punonjësit

**4. MBAJTJA E LLOGARIVE DHE TË
DHËNAVE FINANCIARE**

4.1 Pagimi i detyrimeve tatimore

4.2 Pagimi i detyrimeve të sigurimeve shoqërore

4.3 Pagimi i detyrimeve profesionale

4.4 Sesione të trajnimit vazhdues

4.5 Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

5. DOSJET

5.1 Kontrolli mbi numrin e dosjeve

5.2 Aspekte të përgjithshme të dosjeve

5.3 Përmbajtja – procedura

5.4 Çështje financiare

5.5 Rregulla për tarifat

6. KOMENTE DHE NËNSHKRIME



HYRJE

1.1 Qëllimi i kontrollit të veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë

Misioni i Ministrisë së Drejtësisë është të kërkojë respektimin e Kushtetutës, ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë¹.

Në përmbushje të këtij misioni, Ministria e Drejtësisë është ngarkuar nga legjislacioni në fuqi me mbikëqyrjen, kontrollin, inspektimin dhe kryerjen e procedimit disiplinor për profesionin e përmbauesit privat dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fushën përkatëse² konkretisht, parashikimet e ligjit për shërbimin përmbaues gjyqësor privat,³ ku parashikohet roli i Ministrisë së Drejtësisë për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga përmbauesit gjyqësorë privatë në ushtrimin e funksionit të tyre.

Thelbi i institutit të inspektimit dhe mekanizmeve të kontrollit është mbrojtja e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

Të gjitha kompetencat monitoruese dhe kontrolluese të Ministrisë së Drejtësisë, sa i takon mënyrës së ushtrimit të profesionit të përmbauesit gjyqësor privat, gjithashtu, synojnë që:

- a) të kontribuojnë në luftën kundër **korruptsionit**;
- b) të kontribuojnë në luftën kundër **shpërdorimit të detyrës nga përmbauesit gjyqësorë privatë**;
- c) të kontribuojnë në luftën kundër **mashtimit**;
- d) të kontribuojnë në luftën kundër **pastrimit të parave**;
- e) të rrisin **transparencën** e ekzekutimit të vendimeve;
- f) të shmangin **arbitraritetin**.

¹ Sanksionuar në nenin 5, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar (në vijim "LMD").

² Neni 6, pika 18/1 e LMD-së.

³ Sanksionuar në nenin 58, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat". (Në vijim "LSHPGP").

1.2 Objektivat e kontrollit

Realizimi i misionit dhe i detyrave të Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të inspektimit dhe të mekanizmeve të kontrollit të përmbauesve gjyqësorë privatë arrihet nëpërmjet:

- vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- dokumentimit të praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre;
- këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- urdhërimit të korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre;
- marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligj.

1.3 Metodologjia e kontrollit

Ministria e Drejtësisë kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë me qëllim garantimin e respektimit të parimit të ligjshmërisë në kryerjen e detyrës, profesionalizmit dhe etikës.

Kontrolli i veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë bazohet në informacionin e mbledhur nga burime të ndryshme lidhur me veprimtarinë e tyre, të cilat përfshijnë:

- a) raportet vjetore që përmbauesi gjyqësor privat paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- b) raportet e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, të paraqitura pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- c) raportet e kontrolleve të përgjithshme apo të veçanta, të kryera nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë;
- ç) ankesat apo kërkesat e përcjella në Ministrinë e Drejtësisë nga palët në procedurën përmbauese apo institucionet shtetërore;
- d) burime të tjera, përfshirë burimet e mundshme të raportimit nga mediat, të dhëna nga grupet e interesit, si dhe të dhënat që rezultojnë nga procedurat gjyqësore civile apo penale.

Kontrolli kryhet nëpërmjet përdorimit të formularëve standard. Përdorimi i një formulari standard për kontrollin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë paraqet **disa avantazhe**:



- grupi i kontrollit procedon në të njëjtën mënyrë pavarësisht përmbaruesit gjyqësor privat/zyrës që kontrollohet;

- është më e lehtë të shmangen hallka të panevojshme ndërmjet grupit të kontrollit dhe përmbaruesve për faktin që lehtësohet rotacioni i grupit të kontrollit;

- lehtësim i mbledhjes së të dhënave;

- krahasimi i të dhënave bëhet më i lehtë nga një vit në tjetrin;

- lehtësim i studimeve krahasuese dhe bazueshmëri më e mirë e rekomandimeve;

- lehtësim i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

2. KONTROLI I VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

2.1 Të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesve të kontrolluar

Përmbaruesi gjyqësor privat dhe stafi i tij/saj mbështet dhe lehtëson kontrollin e grupit të kontrollit, duke respektuar detyrimet e tij gjatë ushtrimit të kontrollit, në përputhje me legjislacionin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat dhe rregullat e detajuara në këtë udhëzim, përkatësisht:

Gjatë kërkesës paraprake (faza e parë e kontrollit)

- Duke dërguar brenda afatit të caktuar nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë dokumentet e kërkuara.

Gjatë vizitës në terren (faza e dytë e kontrollit):

- duke mirëpritur grupin e kontrollit;

- duke u ofruar tryezë pune, kompjuter dhe printer;

- duke qëndruar në dispozicion të tyre gjatë gjithë kontrollit;

- duke marrë pjesë në mënyrë aktive në kontroll, me anë të dhënies së informacionit të duhur dhe të saktë dhe të dokumenteve;

- duke dhënë të gjitha shpjegimet e nevojshme dhe çdo dokument që kërkohet nga grupi i kontrollit;

- duke përgatitur paraprakisht dhe në mënyrë të organizuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga aktet ligjore dhe nënligjore.

Përmbaruesi gjyqësor privat dhe stafi i tij/saj përgjatë procedurës së inspektimit ka të drejtë:

- të njihet me arsyet dhe tematikat e kontrollit, veçanërisht për kontrollet e veçanta;

- t'i jepet kohë e nevojshme dhe e arsyeshme për përgatitjen paraprake të dokumenteve të kërkuara gjatë kërkesës paraprake;

- të deklarojë në lidhje me pretendimet e parashtruara nga grupi i kontrollit dhe deklaratimet e tij/saj të shënohen në dokumentacionin e kontrollit;

- të mos ketë ndikim negativ në kryerjen e detyrave të përmbarimit për publikun nga zhvillimi i procedurave të kontrollit në zyrën e përmbarimit gjyqësor privat.

2.2 Përbërja dhe kompetencat e grupit të kontrollit

Kontrolli i veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë kryhet nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë,⁴ konkretisht nga nëpunësit civilë me detyra të kontrollit dhe të inspektimit, të cilët veprojnë si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë.

Specialistët e strukturës përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë kanë kompetencë të kryejnë hetimin administrativ, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, LSHPGJP-së, si dhe ligjit për inspektimin. Ata duhet të prezantojnë veten dhe të shprehën me mirësjellje, edhe pse roli i tyre nuk është thjesht plotësimi i formularit standard, që është kuadri minimal i kontrollit, por edhe për të marrë nisma gjatë inspektimit dhe për të orientuar kërkimin për çështje të veçanta specifike dhe të rëndësishme.

Në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike, Ministria e Drejtësisë mund të angazhojë ekspertë të jashtëm të pavarur për të marrë pjesë në kontrollin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat. Caktimi i ekspertit bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.⁵ Eksperti i përzgjedhur është i pavarur në kryerjen e ekspertimit dhe paraqitjen e përfundimeve të ekspertimit në çdo rast.

⁴ Pika 8 e nenit 58 të LSHPGJP-së.

⁵ Kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimi i ekspertëve të jashtëm të pavarur që angazhohen në kryerjen e kontrolleve përcaktohen me udhëzimin nr. 13, datë 17.7.2020, të ministrit të Drejtësisë “Udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 13, datë 17.7.2020, “Për miratimin e kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët angazhohen në kryerjen e kontrolleve”.



Kompetencat e grupit të kontrollit përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) të drejtën për të hyrë dhe inspektuar godinat, mjediset, objektet, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron veprimtarinë përmbaresi gjyqësor privat, si dhe për të inspektuar çdo send të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektimi;

b) të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit;

c) të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit;

ç) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime të çdo sendi që lidhet me veprimtarinë e përmbaresit gjyqësor privat;

d) të inspektojë çdo dokument apo regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër;

dh) të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit;

e) t'i kërkojë përmbaresve gjyqësor privatë apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektimin;

ë) të administrojë çdo mjet tjetër prove, sipas Kodit të Procedurave Administrative, për përcaktimin e situatës faktike dhe rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar;

Inspektori, gjatë inspektimit, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm, i interesit publik apo palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare.

Këto masat urgjente janë:

a) ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;

b) çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

2.3 Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të kontrollit

Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të kontrollit bëhet në raport me përvojën e tyre teorike dhe

praktike në të drejtën civile, konkretisht, mbi profesionet e lira dhe shërbimin përmbarimor privat. Ata duhet të kenë, gjithashtu, njohuri të mira kompjuterike.

Grupi i kontrollit është “zbulues” efektiv i shkeljeve ose parregullsive që do të thotë që kanë aftësi dhe personalitet për të marrë nisma gjatë kontrollit dhe për të orientuar kërkimet e tyre për çështje specifike dhe të rëndësishme.

Për të shmangur rrezikun e hallkave të padëshirueshme ndërmjet grupit të kontrollit dhe përmbaresve, duhet që i njëjti përmbares ose zyrë përmbarimore të kontrollohet nga nëpunës të Ministrisë së Drejtësisë ose ekspertë të jashtëm të pavarur, të ndryshëm, nga ata që kanë kryer kontrollin e parë.

3. KONTROLLI

Kontrolli i veprimtarisë së përmbaresit gjyqësor privat apo zyrës së përmbarimit është një proces përmes të cilit Ministria e Drejtësisë analizon përmbushjen e kushteve formale ligjore, si dhe verifikon zbatimin e standardeve profesionale të përmbaresve gjyqësorë privatë.

Ministria e Drejtësisë kryen dy lloje kontrollesh:

- **kontrolli i përgjithshëm**, i cili kryhet në tërësi ndaj të gjithë veprimtarisë së përmbaresit gjyqësor privat, në bazë të periodicitetit dhe planit të kontrollit të përgatitur nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë;

- **kontrolli i veçantë**, i cili kryhet për një çështje të caktuar apo një aspekt të caktuar të veprimtarisë së përmbaresit gjyqësor privat.

- **Kontrolli i përgjithshëm** kryhet të paktën çdo katër vjet dhe ka si objekt të gjithë veprimtarinë e përmbaresit gjyqësor privat apo zyrës së përmbarimit. Ky kontroll kryhet mbi bazën e planifikimit të përgatitur nga struktura përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, duke u bazuar në parimin e periodicitetit, transparencës dhe efektivitetit.

Çdo vit, brenda muajit janar, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë përgatit planifikimin e kontrolleve të përgjithshme që do të kryhen gjatë atij viti kalendarik dhe ia paraqet për miratim ministrit të Drejtësisë.

Kontrolli i veçantë kryhet pas identifikimit të problemeve të mundshme disiplinore që kërkojnë hetime shtesë me qëllim verifikimi. Ky kontroll është i përqendruar në çështje të caktuara, për të cilat strukturat përgjegjëse kanë evidentuar



problematika të veçanta, apo janë informuar mbi bazën e ankesave apo informacioneve të paraqitura nga subjekte të interesuara.

Kontrolli bëhet në dy faza:

- kontroll i papritur (kërkesë paraprake) duke dërguar brenda afatit të caktuar nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë dokumentet që janë kërkuar nga grupi i kontrollit;

- kontrolli në terren në ditën e caktuar (vizita në terren).

Përmbauesi duhet të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. Identifikimi i përmbauesit gjyqësor privat apo zyrës së përmbaimit pasqyrohet në formularin standard, sipas tabelës nr. 1, në shtojcën bashkëlidhur.

Grupi i kontrollit prezanton veten dhe shprehen me mirësjellje. Identifikimi i grupit të kontrollit pasqyrohet në formularin standard, sipas tabelës nr. 2, në shtojcën bashkëlidhur.

Roli i grupit të kontrollit nuk është thjesht plotësimi i formularit standard, që është kuadri minimal i kontrollit, por edhe për të marrë nisma gjatë kontrollit dhe për të orientuar kërkimin për çështje specifike dhe të rëndësishme. Grupi i kontrollit ka të drejtë të kërkojë dhe të mbajë një kopje të çdo dokumenti që konsideron të nevojshëm për kontrollin. Kopja duhet të jetë e njehsuar me origjinalin me vulën e njomë të përmbauesit gjyqësor privat dhe duhet të citohet tek komentet.

Veprimtaria e grupit të kontrollit konsiston në përcjelljen e rezultatit të kontrollit, në kryerjen e veprimeve hetimore, ata formulojnë propozime, nënvizojnë shkeljet e përsëritura ose kur është rasti propozojnë masa disiplinore.

Grupi i kontrollit ka përgjegjësinë të organizojë kontrole të papritura duke kërkuar nga përmbauesit komunikimin paraprak të dokumenteve. Ata janë përgjegjës për marrjen e dokumenteve të mbajtjes së llogarive, plotësimit të formularit standard, përcjelljes së shkeljeve dhe parregullsive të identifikuara tek autoritetet përkatëse.

Nëse vihen re parregullsi ose shkelje, grupi i kontrollit njofton ministrin e Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë ka të drejtën të hetojë mbi shkeljen e raportuar nga grupi i kontrollit dhe të vendosë për fillimin e procedimit disiplinor. Ministri mund të njoftojë për shkeljen Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe sipas rastit

prokurorinë, autoritetet tatimore ose të sigurimeve shoqërore.

3.1 Kontrolli i përgjithshëm

Kontrolli i përgjithshëm përfshin planifikimin dhe realizimin e kontrollit në zyrën e përmbauesit gjyqësor privat dhe prek të gjithë aspektet e veprimtarive të zyrës, përfshirë veprimtaritë profesionale të përmbauesve (dosjet, kalimin e fondeve, deontologjinë, tarifat etj.) dhe menaxhimin e zyrës (punonjës, detyrime tatimore dhe profesionale etj.).

Kontrolli i përgjithshëm kryhet nga grupi i kontrollit sipas planifikimit të miratuar nga ministri i Drejtësisë. Përmbauesi gjyqësor privat njoftohet për kryerjen e kontrollit të përgjithshëm përmes adresës së postës elektronike të depozituar në Ministrinë e Drejtësisë për komunikimin zyrtar.

Gjatë kontrollit të përgjithshëm, grupi i kontrollit ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e tij, duke përfshirë:

- verifikim i ambienteve të zyrës në drejtim të kriterëve minimale për mjedisin e zyrës, sipas LSHPGJP-së;

- verifikim i pranisë së përmbauesit gjyqësor privat;

- verifikim i ndihmës përmbauesit, sipas rastit dhe verifikimi i kontratës së tij të punës dhe pagesa e kontributeve;

- verifikim i asistentëve administrativë të përmbauesit;

- verifikim i hedhjes së të dhënave në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbaimit Gjyqësor (në vijim “ALBIS”);

- verifikimi i regjistrit standard të kryerjes së veprimtarisë përmbaimore, nëse ka korrigjime në regjistrë;

- verifikim i aplikimit të tarifave përmbaimore, sa është shënuar në regjistrë, duke e verifikuar me aktin ose veprimin në arkiv ose, sipas rastit, me sistemin elektronik të ALBIS;

- verifikim i tarifave të shpallura;

- verifikim i lidhjes së kontratës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale;

- verifikim i pagimit të detyrimeve profesionale;

- verifikim i angazhimit në Programin e Detyrueshëm të Trajnimit Vazhdues;

- verifikim i veprimeve në llogarinë e veçantë bankare dhe veprimeve të tjera financiare që lidhen me procedurat e ekzekutimit,



- verifikim i mbajtjes dhe ruajtjes së të dhënave dhe materialeve të tjera arkivore të përmbartuesit gjyqësor privat;

- verifikim i respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Punës dhe legjislacioni në fuqi për sigurimet shoqërore, në lidhje me ndihmës përmbartuesit dhe personat e tjerë të punësuar në zyrën e tij.

Kontrolli sipas aspekteve të veçanta të veprimtarisë së përmbartuesit gjyqësor privat kryhet sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3.4 – 6 të këtij dokumenti.

3.2 Kontrolli i veçantë

Kontrolli i veçantë kryhet pas identifikimit të problemeve të mundshme disiplinore që kërkojnë hetime shitesë me qëllim konstatimin e ekzistencës së problemit dhe natyrën e tij.

Ky lloj kontrolli është i ngjashëm me kontrollin e përgjithshëm, por fokusohet më thellë në çështjet që janë paraqitur, apo ka si qëllim mbledhjen e informacioneve më të detajuara për problematika që kanë rezultuar nga kontrolli i përgjithshëm.

Problematikat mund të paraqiten përmes raportimeve të kontrolleve të mëparshme, ankesave të përcjella pranë Ministrisë së Drejtësisë, raportimeve të përcjella nga vetë përmbartuesit gjyqësorë privatë apo Dhoma, si dhe nga burime të tjera të informacionit.

Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin për kryerjen e kontrollit të veçantë, ku përcaktohet objekti i kontrollit dhe periudha për të cilën ushtrohet kontrolli. Përmbartuesi gjyqësor privat njoftohet të paktën 3 ditë përpara për kryerjen e kontrollit edhe përmes adresës së postës elektronike të depozituar në Ministrinë e Drejtësisë për komunikimin zyrtar. Përgjithësisht, në raste urgjente, kontrolli i veçantë mund të kryhet edhe pa paralajmërim.

3.3 Fazat e kontrollit

Kontrolli kryhet në dy faza:

- faza e parë e kontrollit: kërkesa paraprake;
- faza e dytë e kontrollit: vizita në terren.

Në fazën e parë, përmbartuesi merr në adresën e postës elektronike një kopje të urdhrin të ministrit dhe një listë të dokumenteve të kërkuara. Ai duhet të sigurojë të gjitha dokumentet e listës brenda afatit të caktuar nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë përmes të njëjtës adresë të postës elektronike nga e cila ka marrë njoftimin. Në rast se ai/ajo nuk e ndërmerr një veprim të tillë, atëherë grupi i kontrollit e përmend atë (komentet, fundi i dokumentit). Grupi i kontrollit verifikon dokumentet e kërkuara dhe të marra nga përmbartuesi përpara vizitës në terren.

Në kontrollin e përgjithshëm, përveç dokumenteve të kërkuara në fazën e parë dhe që duhet të sigurohen nga përmbartuesi gjyqësor privat brenda afatit të caktuar nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë, grupi i kontrollit i dërgon përmbartuesit edhe listën e dokumenteve të cilat duhet të përgatiten dhe t'i paraqiten grupit të kontrollit ditën e vizitës në terren. Lista e dokumenteve që kërkohen paraqitet në tabelën nr. 4, në shtojcën bashkëlidhur.

Në fazën e dytë, grupi i kontrollit vijon me vizitën në zyrën e përmbartuesit gjyqësor privat. Gjatë vizitës në zyrë, përmbartuesi ka detyrimin të vërë në dispozicion të grupit të kontrollit:

- çdo informacion dhe dokument të kërkuar;
- tavolinë pune, kompjuter dhe printer;
- shpjegime të nevojshme mbi veprimtarinë që është objekt i kontrollit.

Në vizitën në terren, grupi i kontrollit merr në konsideratë edhe kontrollet e mëparshme të kryera ndaj përmbartuesit gjyqësor privat, sipas tabelës më poshtë:

3.3.1 Kontrolli i mëparshëm në terren

Qëllimi	-Objektivi i paragrafit 3.3.1 është përmbledhja në të njëjtën tabelë e historisë së inspektimeve të mëparshme (të kryera vitet e kaluara ose edhe vitin aktual në rast të kontrollit të përgjithshëm apo të veçantë).
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Përpara vizitës të vitit aktual, grupi i kontrollit plotëson tabelën e mëposhtme (nëse zyra funksionon prej më shumë se një viti) duke treguar datën e inspektimeve të mëparshme. Një numër kontrollesh të mëparshme mund të jetë informacion i rëndësishëm. -Kur del në terren, grupi i kontrollit merr dhe mban gjithë dokumentet e kontrolleve të mëparshme për të verifikuar nëse janë realizuar apo jo rekomandimet nga kontrollet e mëparshme.



	Viti 3 (data)	Viti 2 (data)	Viti 1 (data)	Viti aktual
Kontrolli i përgjithshëm				NUK VLEN
Kontroll i veçantë				

3.3.2 Kontrolli aktual në terren

Qëllimi	-Nëse kontrolli në terren është shtyrë, tregohet arsyeja.
Detyrimi i përmbarduesit	-Përmbarduesi ka për detyrë të jetë i pranishëm dhe në dispozicion gjatë kontrollit.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Në rast të shtyrjes për shkak të përmbarduesit, të verifikohet nëse ka pasur raste të ngjashme vitet e mëparshme. -Në rast të shtyrjes për shkak të grupit të kontrollit, të verifikohet nëse ka pasur raste të ngjashme vitet e mëparshme (i njëjti përmbardues – i njëjti grup kontrolli).

Në rast se këtë vit vizita në terren është shtyrë, tregoni arsyen:	
A ka pasur raste të ngjashme vitet e mëparshme?	

3.4 Vendndodhja – sipërfaqja

Qëllimi	-Të sigurohet nëse zyra është e përshtatshme dhe ofron kushtet e duhura për punë dhe për pritjen e klientëve/palëve.
Detyrimi i përmbarduesit	-Përmbarduesi është pjesë e sistemit të drejtësisë. Zyra e përmbarduesit është pjesë e imazhit të drejtësisë dhe duhet të jetë në përputhje me kushtet minimale teknike, të përcaktuara me urdhrin nr. 365, datë 31.05.2021 të ministrit të Drejtësisë “Për kushtet minimale teknike që kanë të bëjnë me infrastrukturën për ushtrimin e veprimtarisë përmbardimore”.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Të kontrollohet nëse kushtet e punës dhe pritjes së klientëve përmbushin kërkesat përkatëse të akteve ligjore dhe nënligjore. -Në tabelën e parë, grupi i kontrollit tregon vendndodhjen e zyrës. -Në tabelën e dytë, grupi i kontrollit tregon destinacionin e çdo hapësire pune, sipërfaqen dhe një koment të përgjithshëm për kushtet teknike si sipërfaqen, mobilitet etj.

Adresa:	
Kati:	
Detaje:	

Tabela 1

Salla	Destinacioni (salla përdoret për ...)	Sipërfaqja me përafërsi	Komente për madhësinë, ndriçimin, mobilitet etj.
Salla e pritjes	pritje	m ²	
Salla 1		m ²	
Salla 2		m ²	
Salla 3		m ²	
		m ²	



		m ²	
		m ²	
Arkiva		m ²	
		m ²	
		m ²	

Komente të grupit të kontrollit:

--

Tabela 2

3.5 Punonjësit

Qëllimi	-Të identifikohet stafi. -Të kontrollohen kontratat e punës. -Të kontrollohet zbatimi i legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
Detyrimi i përmbaruesit	-Të paraqesë menjëherë dokumentet e kërkuara. -T'i japë menjëherë grupit të kontrollit të gjithë informacionin e duhur.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Grupi i kontrollit plotëson me kujdes tabelën.

Emri	Mbiemri	Numri ID	Pozicioni	Data e kontratës së punësimit	Paga mujore (bruto)	Në përputhje me legjislacionin (P/J)

4. MBAJTJA E LLOGARIVE DHE E TË DHËNAVE FINANCIARE

Qëllimi	-Të kontrollohet nëse përmbaruesi i ka të gjitha dokumentet e kërkuara nga aktet ligjore dhe nënligjore për mbajtjen e llogarive dhe kujdesin që ai nuk kryen tërheqje nga llogaria e veçantë për procedurat e ekzekutimit, por vetëm transferime në lidhje me procedurat e ekzekutimit sipas ligjit.
Detyrimi i përmbaruesit	-Të paraqesë menjëherë dokumentet e kërkuara nga grupi i kontrollit. -T'i japë menjëherë grupit të kontrollit të gjithë informacionin e duhur.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Kur dokumentet janë paraqitur nga përmbaruesi gjyqësor privat, atëherë grupi i kontrollit jep aprovimin për to. -Grupi i kontrollit në tabelën e mëposhtme shënon që çdo dokument është mbajtur (kolona "Mbajtur"). -Grupi i kontrollit nuk hyn në detaje: grupi i kontrollit nuk zëvendëson inspektorët tatimorë, por pasqyron faktet e konstatuara në raportin drejtuar ministrit të Drejtësisë, i cili, sipas rastit, mund të informojë autoritetet tatimore në rast se dokumentet e llogarive nuk janë mbajtur (konkretisht, nëse në kolonën "Mbajtur" shënohet "Jo"). -Që nga kontrolli i fundit i grupit të kontrollit, nëse autoritetet tatimore kanë inspektuar dokumentet e mbajtjes së llogarive, grupi i kontrollit plotëson kolonën "Mbajtur" dhe tregon datën e kontrollit nga autoritetet tatimore në kolonën "dokument që pasqyron kontrollin nga autoritetet tatimore". E RËNDËSISHME: deklarata e përmbaruesit që autoritetet tatimore kanë inspektuar mbajtjen e llogarive nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konfirmohet nga një dokument që pasqyron kontrollin apo aprovimin nga autoritetet tatimore.



Tipi i llogarisë	Emri i zotëruesit të llogarisë	Mbajtur (Po/Jo)	Komente mbi mbajtjen e llogarisë në përputhje me ligjin	Dokument që pasqyron kontrollin apo aprovimin nga autoritetet tatimore (nëse po, datën)
Llogaria bankare e veçantë për procedurat e ekzekutimit				
Llogaria bankare e veçantë me qëllim ushtrimin e veprimtarive dytësore				

4.1 Pagimi i detyrimeve tatimore

Qëllimi	-Të kontrollohet nëse përmbaruesi i ka deklaruar në kohë detyrimet tatimore. -Përmbaruesit janë pjesë e sistemit të drejtësisë. Puna e tyre nuk është njësoj si të tjerët dhe për këtë arsye duhet të kontrollohet jo vetëm nga autoritetet tatimore, por dhe nga kontrolli i veçantë i Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me legjislacionin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat. -Vonesa ose mosdeklarimi i të dhënave tatimore konsiderohet shkelje dhe duhet të bëhet shkak për procedurë disiplinore, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 84 të LSHPGJP.
Detyrimi i përmbaruesit	-Të sigurojë ditën e kontrollit të gjithë informacionin e kërkuar. -Të japë ditën e kontrollit çdo shpjegim të kërkuar.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Grupi i kontrollit shkon në zyrë me një listë të siguruar nga administrata tatimore e cila ka lidhje me situatën e përmbaruesve. -Grupi i kontrollit kërkon që <u>deklarimi tatimor</u> të jetë bërë në kohë. Nëse jo, ata i drejtohen ministrit të Drejtësisë, i cili informon sipas rastit autoritetet tatimore, Prokurorinë dhe Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë. -Nëse vlen, grupi i kontrollit tregon që ekziston një vërtetim i pagesës i lëshuar nga autoritetet tatimore (të tregohet data e vërtetimit).

Dokumente dhe referenca	Data e deklarimit	Vërtetim nga autoritetet tatimore
Deklarim i tatimit mbi të ardhurat		
TVSH		
Etj.		

Komentet e grupit të kontrollit:

4.2 Pagimi i detyrimeve të sigurimeve shoqërore

Qëllimi	-Të kontrollohet nëse përmbaruesit kanë paguar në kohë detyrimet e sigurimeve shoqërore. -Përmbaruesit janë pjesë e sistemit të drejtësisë. Puna e tyre nuk është njësoj si të tjerët dhe për këtë arsye duhet të inspektohet jo vetëm nga autoritetet tatimore, ashtu si puna e çdo qytetari, por dhe nga kontrolli i veçantë i Ministrisë së Drejtësisë. -Vonesa ose mospagimi i detyrimeve që lidhen me sigurimet shoqërore mund të përbëjë shkak për procedim disiplinor në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 84 të LSHPGJP.
Detyrimi i përmbaruesit	-Të sigurojë ditën e kontrollit të gjithë informacionin e kërkuar. -Të japë ditën e kontrollit çdo shpjegim të kërkuar.
Udhëzime për grupin e kontrollit	-Grupi i kontrollit shkon në zyrë me një listë të siguruar nga administrata tatimore e cila ka lidhje me situatën e përmbaruesve. Grupi i kontrollit kontrollon që detyrimet e sigurimeve shoqërore janë <u>paguar</u> në kohë. Nëse jo, duhet të pasqyrojë këtë fakt në raportin drejtuar ministrit të Drejtësisë, i cili informon sipas rastit institucionet përgjegjëse dhe Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.



KUIDES! Grupi i kontrollit ka përgjegjësi të kontrollojë që pagesa është kryer (për shembull, me një vërtetim pagese të lëshuar nga autoritetet e sigurimeve shoqërore. Kopja e një çeku nuk është provë sepse nuk është e qartë nëse çeku është dërguar apo jo).

-Nëse ka, grupi i kontrollit tregon që ekziston një vërtetim i pagesës i lëshuar nga autoritetet e sigurimeve shoqërore (të tregohet data e vërtetimit).

Natyrë e detyrimit	Data e pagesës së fundit	Vërtetim nga autoritetet e sigurimeve shoqërore
Sigurime shoqërore		
Pension		
Sigurime shëndetësore		
<i>Etj.</i>		

Komentet e grupit të kontrollit:

4.3 Pagimi i detyrimeve profesionale

Qëllimi	-Të kontrollohet nëse përmbuesi përmbush detyrimet profesionale ndaj Dhomës Kombëtare të Përmbuesve Gjyqësorë Privatë. Kontrolli fokusohet në detyrimet financiare që do të thotë në <u>pagesën</u> e detyrimeve profesionale (kuotë, tarifë vjetore etj.) -Përmbuesit janë pjesë e sistemit të drejtësisë. Detyrimet e tyre profesionale duhet të kontrollohen nga Dhoma, por, sipas standardeve evropiane, një inspektim i dyfishtë është i nevojshëm për të siguruar që Dhoma i inspekton përmbuesit rregullisht dhe në mënyrë të drejtë. -Mos pagesa duhet të bëhet shkak për procedim disiplinor në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 84 të LSHPGJP.
Detyrimi i përmbuesit	-Të sigurojë ditën e kontrollit të gjithë informacionin e kërkuar. -Të japë ditën e kontrollit çdo shpjegim të kërkuar.
18	Bimët për mbjelljen e <i>Solanaceae</i> përveç farave dhe bimëve të përfshira në pikat 15, 16 ose 17.	ex 0602 90 30 ex 0602 90 45 ex 0602 90 46 ex 0602 90 48 ex 0602 90 50 ex 0602 90 70 ex 0602 90 91 ex 0602 90 99	Të gjitha vendet përveç Algjerisë, Andorrës, Armenisë, Azerbajxhanit, vendeve anëtare të BE-së, Bjellorusisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Ishujt Kanarie, Egjiptit, Ishujt Faroe, Kosovës, Gjeorgjisë, Islandas, Izraelit, Jordanisë, Libanit, Libiasë, Lihtenshtajnit, Moldavisë, Monakos, Malit të Zi, Marokut, Maqedonisë së Veriut, Norvegjisë, Ruisë (vetëm pjesët e mëposhtme: Qarkut Federal Qendror (Tsentralny Federalny okrug), Qarkut Federal Veriperëndimor (Severo-Zapadny Federalny okrug), Qarkut Federal Jugor (Yuzhny



Nr.	Përshkrimi	Kodi NK	Vendet, grupi i vendeve, ose zona specifike e vendit
			Federalny okrug), Qarkut Federal i Kaukazit të Veriut (Severo-Kavkazsky federal okrug) dhe Qarkut federal i Vollgës (Privolzhsky federalny okrug)), San Marinos, Serbisë, Zvicrës, Sirisë, Tunizisë, Turqisë, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar.
19	Toka si e tillë që përbëhet pjesërisht nga substanca të ngurta organike.	ex 2530 90 00 ex 3824 99 93	Të gjitha vendet përveç Zvicrës dhe vendeve anëtare të BE-së.
20	Terren rritës si i tillë, përveç tokës, i përbërë tërësisht ose pjesërisht nga substanca organike të ngurta, përveç atij të përbërë tërësisht nga torfe ose fibra e <i>Cocos nucifera</i> L., e pa përdorur më parë për rritjen e bimëve ose për qëllime bujqësore.	ex 2530 10 00 ex 2530 90 00 ex 2703 00 00 ex 3101 00 00 ex 3824 99 93	Të gjitha vendet përveç Zvicrës dhe vendeve anëtare të BE-së.
21	Limon <i>Citrus limon</i> (L.) N. Burm.f. dhe Portokall <i>Citrus</i>	ex 0805 50 10 0805 10 22 0805 10 24	Argjentina.
22	Toka si e tillë që përbëhet pjesërisht nga substanca të ngurta organike.	ex 2530 90 00 ex 3824 99 93	Të gjitha vendet përveç Zvicrës dhe vendeve anëtare të BE-së dhe Kosovës.
23	Terren rritës si i tillë, përveç tokës, i përbërë tërësisht ose pjesërisht nga substanca organike të ngurta, përveç atij të përbërë tërësisht nga torfe ose fibra e <i>Cocos nucifera</i> L., e pa përdorur më parë për rritjen e bimëve ose për qëllime bujqësore.	ex 2530 10 00 ex 2530 90 00 ex 2703 00 00 ex 3101 00 00 ex 3824 99 93	Të gjitha vendet përveç Zvicrës dhe vendeve anëtare të BE-së dhe Kosovës.
24	Limon <i>Citrus limon</i> (L.) N. Burm.f. dhe Portokall <i>Citrus sinensis</i> (L.) Osbeck (deri më 30 prill 2021).	ex 0805 50 10 0805 10 22 0805 10 24 0805 10 28 ex 0805 10 80	Argjentina.



VENDIM

Nr. 286, datë 10.11.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 242, DATË 23.9.2022, TË BORDIT TË ERE-s, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ”

Në mbështetje të neneve 1, 83, 85, pikat 1 dhe 2, 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 12, nenit 105, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 7, germa “g”, e “Metodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/8 prot., datë 8.11.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi një ndryshim në vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”,

konstatoi se:

- ERE, me shkresën nr. 1610/8 prot., datë 28.10.2022, ka kërkuar informacion nga shoqëria FSHU sh.a., duke bërë me dije edhe shoqërinë KESH sh.a., lidhur me kostot e blerjes së energjisë

elektrike të FSHU sh.a. për muajin nëntor 2022, mbi energjinë e cila pritët të livrohet nga shoqëria KESH sh.a. Më datë 6.10.2022, ERE u njoh me vendimin nr. 6490/5 prot., datë 5.10.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nga cili rezulton ndryshimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.

- Shoqëria FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE shkresën nr. 7939/1 prot., datë 4.11.2022, në të cilën ka bërë me dije kostot që duhen të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët familjarë për muajin nëntor 2022.

- Shoqëria FSHU sh.a. është shprehur, se KESH sh.a., me anë të shkresës me nr. 4820/12 prot., datë 4.11.2022 ka njoftuar shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin nr. 863/1, datë 4.11.2002, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, e cila ka miratuar vendimin nr. 14, datë 1.11.2022, të Këshillit Mbikëqyrës, “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. për muajin nëntor 2022”, në të cilin është vendosur pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 7.9.2022 dhe vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 6651/1, datë 8.9.2022, për muajin nëntor 2022, si dhe vijimin e tarifimit për shitjen e energjisë për shoqërinë FSHU sh.a., sipas tabelës së paraqitur më poshtë:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

- Në kushtet kur nga organet vendimmarrëse të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) është vendosur pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 7.9.2022, për muajin nëntor 2022, duke lënë në fuqi çmimin e shitjes së energjisë për konsumatorët familjarë (pavarësisht sasisë së energjisë elektrike të konsumuar) prej 2.6 lekësh/kwh, atëherë rezulton se kostot e blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a., për këtë kategori konsumatorësh, për muajin nëntor 2022 mbeten të pandryshuara.

- Shoqëria FSHU sh.a. ka kërkuar nga ERE reflektimin e vendimit sa më sipër, në përcaktimin



e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë për klientët familjarë, për muajin nëntor 2022, duke u aplikuar çmimi i përcaktuar me vendimin nr. 74, datë 23.4.2022, të Bordit të ERE-s.

- Në kushtet kur kostot e blerjes së energjisë elektrike për muajin nëntor 2022 nga ana e FSHU sh.a. janë të njëjta me kostot e blerjes së energjisë përpara marrjes së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, vlerësojmë se çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga shoqëria FSHU sh.a. për muajin nëntor 2022, të vijojnë të jenë ato të miratuar në vendimin nr. 74/2022 të Bordit të ERE-s.

- Meqenëse ekzistojnë mundësitë e rishikimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., nga shoqëria KESH sh.a. edhe për muajin dhjetor 2022, bazuar në përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomik, sikurse ndodhur gjatë muajve tetor dhe nëntor 2022, në rastin se kostoja e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a., në zbatim të VKM-së nr. 456/2022, do të vijojë të jetë ajo e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a. prej 2.6 lekësh/kwh, për të gjithë konsumatorët të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, do të jetë e nevojshme që ERE të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, duke lënë në fuqi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të miratuara me anë të vendimit nr. 74/2022 të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, si më poshtë:

- “Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekësh/kwh për konsumin mbi 800 kwh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 dhjetor–31 dhjetor 2022”.

2. Lënien në fuqi të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të FSHU sh.a., për

konsumatorët familjarë prej 9.5 lekësh/kwh, të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, për muajin nëntor 2022.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 nëntor 2022.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 287, datë 10.11.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2022, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/9 prot., datë 8.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin



tetor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatohet se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 7865 prot., datë 3.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 1924 prot., datë 8.11.2022, ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2022, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë rezulton se çmimi i propozuar për muajin tetor 2022, për këtë kategori klientësh, është 31.58 lekë/kWh, ku përpos elementeve të çmimit të njohur nga “Metodologjia e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, shoqëria ka përfshirë, gjithashtu, edhe kostot e disbalancave.

- Sqarojmë, se në lidhje me kërkesën e FSHU sh.a., mbi reflektimin e kostove të disbalancave në çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja, në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar: tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e livrimit mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktohet në Metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe do të faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, kostot e

disbalancave nuk njihen si komponent i përlogaritjes së çmimit të FMF-së.

- Mbështetur në nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 74, datë 13.4.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga shoqëria FSHU sh.a. për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, janë njohur në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Kursi i këmbimit (euro/lek) i marrë në konsideratë për datën 31.10.2022 është 1 EUR = 118.07 lekë.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2022, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2022		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	27.22
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.82
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh 31.50



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 31.50 lekë/kwh për muajin tetor 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2022, prej 31.50 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 288, datë 10.11.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDRO ENERGIA PULITA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit

Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/1 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Idro Energia Pulita’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 259, datë 10.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Idro Energia Pulita” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 12.10.2022 dhe 13.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 21.10.2022), nuk rezulton të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 11719/1 prot., datë 12.10.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Idro Energia Pulita” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”, dhe pikën 2.5.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,



njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Idro Energja Pulita” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 289, datë 10.11.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO ENERGY SOTIRA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022,

mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/4 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Hydro Energy Sotira’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 10.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hydro Energy Sotira” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 12.10.2022 dhe 13.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga aplikimi rezultoi se shoqëria “Hydro Energy Sotira” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores: për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikën 2.5.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Energy Sotira” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 290, datë 10.11.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES
SË BORDIT TË ERE-s MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“CONSTRUCTION ENERGY PARTS
(C.E.P.)” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/3 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Construction Energy Parts’

sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 264, datë 14.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2022 dhe 17.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar në zbatim të rregullores. Nga shoqëria kërkohet që të dokumentojë mbështetjen financiare të saj, pasi letra e interesit me një bankë të nivelit të dytë e depozituar në ERE në kuadër të mbështetjes financiare mban datën 21.06.2022 dhe pas kësaj date nuk është depozituar ndonjë informacion, në lidhje me vijimin e kësaj procedure. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se një pjesë të investimit do të kryhet nga zhvilluesi ndaj kërkohet të dokumentohet në ERE, nëse kompania vë në dispozicion të zhvillimit të këtij projekti të ardhurat financiare për mbulimin e pjesës së investimit që do të kryhet nga zhvilluesi.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e



licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rast pas rasti, konkretisht: Pika 3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Duke qenë se shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar, i cili duhet të depozitohet brenda 10 (dhjetë) ditëve në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Construction Energy Parts” (C.E.P.) sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 291, datë 10.11.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROPOWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/2 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 14.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2022 dhe 17.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e



prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitohet në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar në zbatim të rregullores. Nga shoqëria kërkohet që të dokumentojë mbështetjen financiare të saj, pasi letra e interesit me një bankë të nivelit të dytë, e depozituar në ERE në kuadër të mbështetjes financiare mban datën 21.6.2022, dhe pas kësaj date nuk është depozituar ndonjë informacion në lidhje me vijimin e kësaj procedure. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se një pjesë të investimit do të kryhet nga zhvilluesi ndaj kërkohet të dokumentohet në ERE, nëse kompania vë në dispozicion të zhvillimit të këtij projekti të ardhurat financiare për mbulimin e pjesës së investimit që do të kryhet nga zhvilluesi. Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rast pas rasti, konkretisht: Pika 3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Duke qenë se shoqëria “Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2

mw, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar, i cili duhet të depozitohet brenda 10 (dhjetë) ditëve në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria “Hydropower” sh.p.k. të depozitohet në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 292, datë 10.11.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIMAX ALBANIA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, ME VENDNDODHJE NË POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në



sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Dimax Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 265, datë 14.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2022 dhe 17.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1749/1 prot., datë 21.10.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Në vijim shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1749/2 prot., datë 28.10.2022.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezultoi se shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar në zbatim të rregullores. Nga shoqëria kërkohet që të dokumentojë mbështetjen financiare të saj, pasi letra e interesit me një bankë të nivelit të dytë e depozituar në ERE në kuadër të mbështetjes financiare mban datën 22.6.2022 dhe, pas kësaj date, nuk është depozituar ndonjë informacion në lidhje me vijimin e kësaj procedure. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se një pjesë të investimit do të kryhet nga zhvilluesi ndaj kërkohet të dokumentohet në ERE, nëse kompania vë në dispozicion të zhvillimit të këtij projekti të ardhurat financiare për mbulimin e pjesës së investimit që do të kryhet nga zhvilluesi.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rast pas rasti, konkretisht: Pika 3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Duke qenë se shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar, i cili duhet të depozitohet brenda 10 (dhjetë) ditëve në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative



Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 293, datë 10.11.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBSOLAR” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK “ALBSOLAR
PV PARK 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/10 prot., datë 8.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Albsolar’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Albsolar PV Park 1’, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albsolar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1874 prot., datë 8.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A). Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Albsolar” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores: për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 2.1, germat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.1 Aplikuesi ka depozituar të nënshkruar dhe vulosur formatin e aplikimit, sipas rregullores së vjetër ndaj në të tilla rrethana në vijim duhet ta përcjellë sipas shtojcës 1, germat “a”, “b”, “c”, që është aktualisht në fuqi.

Pika 1.2 “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) edhe për shoqërinë “Albsolar” sh.p.k.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë të nënshkruar dhe vulosur nga administratori strukturën organizative të saj dhe të bëjë me dije, se



cila pjesë e strukturës do të jetë në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

- Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Germa “a”: Në vijim shoqëria duhet të përcjellë të dhënat teknike për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas shtojcës 2 të rregullores së licencimit, si dhe të bëjë me dije nëse ka filluar punimet apo fazën në të cilën ndodhen, duke qenë se ka deklaruar se data e fillimit të operimit do të jetë 30.12.2022. Po ashtu duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 49 vjetësh të centralit fotovoltaik, pasi nga rastet analoge të mëhershme, ka rezultuar se jetëgjatësia e një centrali fotovoltaik, teknikisht nuk mund të jetë më tepër se 25 vjet.

- Bazuar në aktet e përfaqësimit dhe në deklaratën e vetë shoqërive, vlerësohet e nevojshme që t’i drejtohem edhe MIE-s me një shkresë ku t’i kërkohet informacion në lidhje me shoqërinë që do të operojë centralin fotovoltaik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë